



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 2788/3 Prot.

Durrës, më 19 /02 /2023

**Lënda:** Kërkesë për Shpallje Publike

**Drejtuar:** DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHURAVE  
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE


Tiranë

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, a) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor;

Nr	Vendimi Administrativ		Vendimi Rikuperim me Forcë		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	1220	05.12.2023	8	11.01.2024	SM' & SARKAN MERKURI & TEIDI DORACI	M21915504T & J20424084B & G40718035V	26,785,796	82,357,388	109,143,184

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI  
DENIS SHABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 2096 / Prot.

Durrës, më 02 / 2024

Lënda: Njoftim-Vendimi për Rikuperim me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizë

**Drejtuar: Subjektit "SM" me Nipt./ID M21915504T**

*Rruga "Kripa e Detit" pallati 4, Kati 1 Durres, Durres, DURRES, Durres*

*Email: [tedi.doraci@gmail.com](mailto:tedi.doraci@gmail.com) tel; 0683358095*

**Shtetasit "SARKAN MËRKURI" me NID J20424084B**

*Durrës, Rruga Panjohur; ; ; Durrës; ; 0000;*

**Shtetasit "TEIDI DORACI" me Nipt./ID I41028157V**

*TIRANË, FERIT SHEHU; Nd. 8; H. 1; ; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; NJËSIA BASHKIAKE NR. 3; 1005; TIRANË*

Në zbatim të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor"; Ligji nr.61/2012 "Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",

**Ju njoftojmë se:**

Dega e Doganës Durrës ka nxjerrë "Vendimin për Rikuperim me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizë" **Nr.08, datë 05.02.2024**, (bashkëngjitur).

**Për keto arsye :**

Shoqëria Juaj, menjëherë me njoftimin e Vendimit Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/ **Nr.08, datë 05.02.2024** do të pezullohet në sistemin Asycuda World, referuar Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, Kreu VII, pika nr.2.6.

Sa më sipër, kërkohet paraqitja Juaj pranë Degës Doganore Durrës, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të sipërcituar, mbi pagesën e detyrimeve doganore/akceze, garantimin/pagesën e shumës penalitet si dhe çdo informacion tjetër mbi vijimin e procedurës për rikuperimin e borxhit.

Në rast se ekzekutimit nuk kryhet në mënyrë vullnetare brenda 10 ditësh, Dega e Doganës Durrës do të ndërmarre të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara.

Merrni masat e menjehershme për të likuajduar borxhin doganor / akcize sipas vendimit bashkëlidhur.  
Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!

**KRYETARI  
DENISA SHABANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 209 Prot.

Durrës, më 06.02.2024

**VENDIMI Nr.08, datë 11.01.2024**  
**PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR/AKCIZË**

Në zbatim të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; Ligji nr.61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Dega e Doganës Durrës me vendimin Nr.1220, (nr.19726prot., & nr.19726/1prot.) datë 05.12.2023, ka vendosur për Subjektin “SM” me Nipt M21915504T; Shtetasin “Sarkan Mërkuri” me NID J20424084B; Shtetasin “Teidi Doraci” me Nipt./ID I41028157V, të shpallen debitor për shumën 26,785,796 lekë në formë detyrim doganor, 82,357,388 lekë në formë sanksionesh, si dhe kamat vonest deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky vendim Ju është njoftuar përmes shkresës Nr.19726/2Prot., datë 05.12.2023, me anë të sherbimit postar, Konferma Postare;

- nr. RR524129601AA, drejtuar subjektit “SM”, kthyer zarfi me shënimin postar “*larguar*”.
- nr. RR528763735AA, drejtuar Shtetasit “Sarkan Mërkuri”, kthyer zarfi me shënimin postar “*i panjohur*”.
- nr. RR522678375AA, drejtuar Shtetasit “Teidi Doraci”, kthyer zarfi me shënimin postar “*ka ndryshuar adresë*”.

Në këto kushte Dega e Doganës Durrës, në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë shpalljen publike me anë të shkresës;

- Nr.21029prot., datë 27.12.2023, ku është mundësuar shpallja ne datë 05.01.2024 në faqen zyrtare (online) te Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- Nr.21023prot., datë 27.12.2023, ku është mundësuar shpallja ne datë 24.01.2024 në faqen zyrtare (online) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;
- Nr.21030prot., datë 27.12.2023, ku është mundësuar shpallja ne datë 05.01.2024 në këndin e afishimeve të Njesisë Bashkiake Nr.3, konfirmuar shpallja me shkresën nr.21030/1prot., datë 12.01.2024;
- Nr.21028prot., datë 27.12.2023, ku është mundësuar shpallja ne datë 05.01.2024 në këndin e afishimeve të Bashkisë Durrës, konfirmuar shpallja me shkresën nr.21028/1prot., datë 10.01.2024;

Në kushtet kur nga ana Juaj nuk është ushtruar ankimim ndaj vendimit administrativ, Dega e Doganës Durrës në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor/ nenit 103 të ligjit 61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë” ka nxjerrë Vendimin **Nr.08, datë 11.01.2024** “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”.

Përmes vendimit **Nr.08, datë 11.01.2024** “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”, Dega e Doganës Durrës ka vendosur si me poshtë;

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në banka, që i përkasin debitorit, Subjektit “SM” me Nipt M21915504T; Shtetasit “Sarkan Mërkuri”

me NID J20424084B; Shtetasit “Teidi Doraci” me Nipt./ID I41028157V,, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;

2. Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit Subjektit “SM” me Nipt M21915504T; Shtetasit “Sarkan Mërkuri” me NID J20424084B; Shtetasit “Teidi Doraci” me Nipt./ID I41028157V, ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.
3. Kryerjen e sekuestrimit të mesipërm deri në masën , që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për tu paguar nga subjekti Subjektit “SM” me Nipt M21915504T; Shtetasit “Sarkan Mërkuri” me NID J20424084B; Shtetasit “Teidi Doraci” me Nipt./ID I41028157V, të percaktuar me vendim Nr.1220, (nr.19726prot., & nr.19726/1prot.) datë 05.12.2023, në shumën **26,785,796 lekë** në formë detyrim doganor, **82,357,388 lekë** në formë sanksionesh,si dhe kamatë vonesat e lindura sipas nenit 107 të Kodit Doganor/Ligjit të Akcizës, në përputhje me normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, për cdo ditë vonesë, nga data e njoftimit të debitorit, deri në datën e likuidimit të të gjitha detyrimeve të papaguara.

**KRYETARI  
DENIS SHABANI**

